

URDHËR

*"për heqjen e sekuestros konservative"*



Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Për dijeni: Ujësjetllës Kanalizime Belsh me Nipt L63215202R

Për dijeni: Inspektoriati Shtetëror Shëndetsor

Pranë Zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Besnik DOKUSHI me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me palë:

Debitori: Ujësjetllës Kanalizime Belsh me Nipt L63215202R

Kreditorit: Inspektoriati Shtetëror Shëndetsor

Objekti: Pagim Gjobe

Unë Përmbaruesi Gjyqësor privat Besnik DOKUSHI pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbarimore:

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv Vendim Gjobe Nr.001255/5 datë 07.09.2018 për subjektin kundravajtës Ujësjetllës Kanalizime Belsh me Nipt L63215202R dhe me palë kreditore Inspektoriati Shtetëror Shëndetsor, është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit Nr.9, datë 20.02.2019 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Durrës me objekt:

*"Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për titullin ekzekutiv Vendim Gjobe Nr.001255/5 datë 07.09.2018 për subjektin kundravajtës Ujësjetllës Kanalizime Belsh me Nipt L63215202R"*

Në datën 09.09.2019 në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e bllokimit në kuotat e palës debitore Ujësjetllës Kanalizime Belsh me Nipt L63215202R.

Duke qënë se pala debitore Ujësjetllës Kanalizime Belsh me Nipt L63215202R ka shlyer detyrimin kundrejt palës kreditore Inspektoriati Shtetëror Shëndetsor.

URDHEROJ:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit, të bëjë heqjen bllokimit e kuotave të Ujësjetllës Kanalizime Belsh me Nipt L63215202R.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dh në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
3. Ky urdhër mbahet ne 5 kopje e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brënda 5 ditëve nga marja dijeni.

